



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM

Nr.195, datë 12.05.2021

**PËR
MIRATIMIN E “RREGULLA PËR PËRZGJEDHJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE NË
PROCESIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË
NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

RREGULLA PËR PËRZGJEDHJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE NË PROCESIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË

Kreu I

Parime të përgjithshme

1. Përzgjedhja e çështjeve me short realizohet pas fillimit të procedurës së vlerësimit dhe është pjesë përbërëse e kësaj procedure.
2. Përzgjedhja e çështjeve me short realizohet në mënyrë elektronike nga administrata gjyqësore. Kur kjo nuk është e mundur shorti zhvillohet në mënyrë manuale.
3. Shorti zhvillohet në ambientet e Gjykatës së Lartë.
4. Shorti konsiston në një përzgjedhje rastësore të çështjeve të përfunduara në Gjykatën e Lartë, brenda periudhës së vlerësimit dhe realizohet në mënyrë transparente në praninë e detyrueshme të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, të ndihmësmagjistratit subjekt vlerësimi, të kancelarit, një sekretareje gjyqësore dhe të nëpunësit të gjykatës që punon në fushën e teknologjisë së informacionit. Kanë të drejtë të marrin pjesë, çdo anëtar i Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale si dhe një punonjës IT i KLGJ-së.
5. Data, ora dhe vendi i zhvillimit të shortit përcaktohen me vendim të relatorit, i cili i njoftohet ndihmësmagjistratit, kancelarit dhe kryetarit të gjykatës, jo më vonë se 2 ditë para ditës së organizimit të shortit.
6. Kryetari dhe kancelari i gjykatës marrin masa për t'i krijuar nëpunësit përgjegjës të gjitha kushtet e nevojshme për ushtrimin e detyrës.
7. Mbi bazën e tabelave statistikore dhe Kolegjin ku ka ushtruar detyrën ndihmësmagjistrati, relatori përcakton me vendim numrin dhe kategoritë e çështjeve që do të përzgjidhen me short, për secilin vit vlerësimi. Përzgjedhja duhet të jetë e tillë që të përfaqësojë aspekte të ndryshme të të gjithë punës profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.
8. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit ndihmësmagjistrati ka munguar në detyrë për më shumë se 6 muaj, numri i çështjeve që përzgjidhen për vlerësim etik dhe profesional, përkatësisht 15 ose 6 çështje për vlerësim të përgjithshëm dhe jo më shumë se 6 ose 3 çështje për ato të përgatitura tej afateve standarde, në varësi të periudhës së vlerësimit, do të ulet në mënyrë proporcionale me kohën.
9. Në short përfshihen të gjitha çështjet e përfunduara në të cilat ndihmësmagjistrati ka përpiluar dokumentin ligjor duke dhënë mendim në përgatitjen e analizës ligjore, relacionit sipas udhëzimeve të gjyqtarit relator apo të Kolegjit ku ka qenë i angazhuar.

Kreu II

Kriteret mbi të cilat relatori përcakton numrin dhe kategoritë e çështjeve që përzgjidhen me short

10. Numri total i çështjeve që përzgjidhen me short përcaktohet nga relatori në varësi të periudhës së vlerësimit, bazuar në kriteret e mëposhtme:

a. Kriteri vjetor për vlerësimin e përgjithshëm.

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen për procesin e vlerësimit referuar periudhës së vlerësimit, si më poshtë :

i. nëse vlerësimi është pesëvjeçar, do të përzgjidhen 3 çështje për çdo vit kalendarik.

ii. nëse vlerësimi është trevjeçar, do të përzgjidhen 5 çështje për çdo vit kalendarik.

iii. nëse vlerësimi është njëvjeçar (i përshpejtuar), do të përzgjidhen 6 çështje.

b. Kriteri i vonesës në afate.

Sipas këtij kriteri relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen sipas vonesës në afate, referuar tabelës së hartuar nga nëpunësi përgjegjës, menjëherë pas fillimit të procesit të vlerësimit, sipas formatit standard (Aneksi i bashkëlidhur këtij akti). Nëse ka çështje të përfunduara ku ndihmësmagjistrati ka tejkalar standardin minimal kohor në përgatitjen e dokumentit ligjor, atëherë prej tyre përzgjidhen 5 %, por jo më shumë se 6 çështje. Në rastin e vlerësimit 1-vjeçar, numri i çështjeve që përzgjidhen është sërish 5 %, por jo më shumë se 3 çështje.

11. Numri i çështjeve që do të përzgjidhen me short për vlerësim të përgjithshëm, përcaktohet nga relatori në zbatim të nenit 91 të Ligjit për Statusin, për aq sa ai është i zbatueshëm, në varësi të periudhës së vlerësimit, bazuar në kriteret e mëposhtme:

a. Kriteri gjithëpërfshirës i përzgjedhjes

Sipas këtij kriteri, relatori duhet të kujdeset që përzgjedhja të mbulojë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të përgatitura nga ndihmësmagjistrati subjekt vlerësimi, në të gjitha Kolegjet në të cilat ai është angazhuar me përgatitjen e materialeve për gjykimin e çështjeve. Përzgjedhja sipas Kolegjeve mundëson përfshirjen në vlerësim të gjithë kategorive të çështjeve civile, penale, dhe administrative.

b. Kriteri i barazisë në përzgjedhjen e çështjeve sipas Kolegjeve

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen sipas Kolegjeve (civil, penal dhe administrativ), në varësi të numrit të çështjeve të përfunduara nga secili prej tyre. Barazia në përzgjedhje nuk është matematikore, por përcaktohet nga relatori në varësi të raportit që zë numri i çështjeve të përfunduara nga secili Kolegj, në numrin total të çështjeve.

c. Kriteri i kompleksitetit të çështjes

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çështjeve që duhet të përzgjidhen për vlerësim, në varësi të ritit procedural të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, më vetë për ato të përfunduara në Dhomë Këshillimi si dhe ato të përfunduara në Seancë Gjyqësore. Numri çështjeve të përzgjedhura përcaktohet nga relatori në varësi të raportit që zë secila prej tyre në numrin total të çështjeve të përfunduara. Bazuar në tabelat statistikore, relatori përcakton Kolegjin dhe vitin kalendarik nga i cili këto çështje do të përzgjidhen me short.

ç. Kriteri i natyrës së çështjes bazuar në mënyrën se si vihet në lëvizje Gjykata e Lartë

Sipas këtij kriteri, relatori, pas përcaktimit të numrit total të çështjeve që duhet të përzgjidhen (vlerësim i përgjithshëm + çështjet e vonesës në afate), përcakton numrin maksimal të çështjeve që nuk janë me objekt “rekurs”, por që kërkojnë vlerësim (kërkesa të tjera) nëse shorti do të përzgjedhë të tilla. Ky numër nuk duhet të jetë më i lartë se 10 % e numrit të përgjithshëm të çështjeve të përzgjedhura.

d. Kriteri i natyrës së vendimit

Nuk përzgjidhen për vlerësim çështjet e përfunduara në Dhomë Këshillimi për shkak të heqjes dorë nga rekursi.

Kreu III

Rregullat e zhvillimit të shortit

12. Shorti zhvillohet mbi bazën e listës së plotë të çështjeve gjyqësore të përfunduara në Gjykatën e Lartë, për të cilat ndihmësmagjistrati ka përpiluar dokumentin ligjor duke dhënë mendim në përgatitjen e analizës ligjore, relacionit sipas udhëzimeve të gjyqtarit relator apo të Kolegjit ku ka qenë i angazhuar.

13. Procedura e shortit ndjek disa hapa përzgjedhjeje të çështjeve sipas vendimit të relatorit e radhës së mëposhtme.

14. Çdo hap përzgjedhjeje bazohet në të dhëna statistikore, pjesë e një tablele të caktuar, sipas urdhrin të relatorit.

15. Procedura e shortit fillon me përzgjedhjen në mënyrë rastësore të çështjeve për të cilat ndihmësmagjistrati ka tejkuluar standardin minimal kohor në përgatitjen e dokumentit ligjor, bazuar në formatin tabelar të hartuar nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

16. Më pas vazhdohet me përzgjedhjen e çështjeve për vlerësimin e përgjithshëm sipas Kolegjeve e tabelave statistikore të përcaktuara në vendimin e relatorit. Në përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim të përgjithshëm, përjashtohen ato që janë përzgjedhur sipas pikës 15.

17. Për të kontrolluar nëse çështja e përzgjedhur me short përmbush kriteret e mësipërme, procedohet menjëherë me verifikimin fizik të çështjes gjyqësore të përzgjedhur. Nëse çështja nuk përmbush kriteret, atëherë ajo nuk konsiderohet dhe procedohet me përzgjedhjen e një çështjeje tjetër. Çështje e përzgjedhur me short nuk konsiderohet as ajo që është përzgjedhur për vlerësim nga vetë ndihmësmagjistrati.

Kreu IV

Dokumentimi i shortit dhe vëzhgimi i dosjeve

18. Çdo veprim i kryer gjatë procedurës së shortit dokumentohet në një procesverbal, sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin Nr. 232 dt.02.07.2020 “*Për miratimin e modelit të procesverbalit për pasqyrimin e veprimeve që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit*”.

19. Ky procesverbal mbahet nga një sekretare gjyqësore dhe nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Nëse ka vërejtje për procedurën e zhvillimit të shortit, ato shënohen në një rubrikë të veçantë të procesverbalit.

20. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet kancelarit të gjykatës për përgatitjen e dosjeve të përzgjedhura dhe dorëzimin e kopjeve të dokumenteve ligjore pjesë e dosjeve të përzgjedhura tek nëpunësi përgjegjës për vlerësimin. Një kopje i dorëzohet ndihmësmagjistratit, ndërsa kopja origjinale bëhet pjesë e dosjes së vlerësimit.

21. Pas dokumentimit të shortit bëhet vëzhgimi (kontrolli) i dosjeve për të parë nëse ato ndodhen në arkivin e Gjykatës së Lartë. Kancelari merr masa për fotokopjimin e të gjitha akteve/materialeve të dosjes së Gjykatës së Lartë dhe ia përcjell ato Këshillit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga e nesërmja e zhvillimit të shortit. Nëse dosjet e çështjeve të përzgjedhura nuk ndodhen në Gjykatën e Lartë, Kancelari njofton nëpunësin përgjegjës për vlerësimin, për Gjykatën ku ndodhet dosja. Nëpunësi përgjegjës për vlerësimin i kërkon gjykatës ku ndodhet dosja, dërgimin e akteve/materialeve të dosjes së Gjykatës së Lartë, sipas procedurës dhe afateve të mësipërme. Aktet e dosjeve të përzgjedhura duhet të jenë të inventarizuara dhe të njësuara me vulën e gjykatës nga e cila dërgohen.

Kreu V

Dispozita kalimtare për gradimin/përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar

22. Për përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, pjesë e të cilit ka qenë edhe periudha e kohës gjatë së cilës kanë qenë të komanduar në Gjykatën e Lartë, përzgjidhen me short për vlerësim 6 dosje shtesë. Nga kjo përzgjedhje, përjashtohen çështjet që kanë qenë pjesë e dosjes së rivlerësimit, sipas nenit 171 pika 5 të Ligjit për Statusin. Për të lehtësuar punën e procedurën e shortit, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, evidenton paraprakisht çështjet e dosjes së rivlerësimit, të përzgjedhura nga ndihmësmagjistrati ose nga shorti.

23. Për kriteret e përzgjedhjes së çështjeve, zhvillimin e shortit, dokumentimin dhe dërgimin e dosjeve të përzgjedhura, zbatohen rregullat e mësipërme.

Aneks I

Format tabelar për çështjet e përgatitura jashtë afateve standarde

Ky format hartohet nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin dhe përmban të listuara vetëm çështjet për të cilat ndihmësmagjistrati ka përgatitur materialet tej afateve të standarde, në dy kolona:

- (1) numrin rendor që tregon vendin në renditjen e çështjeve që do të shorthohen; dhe
- (2) numrin e regjistrimit të çështjes, për të cilën ka punuar ndihmësmagjistrati.

Tabela për çështjet tej afateve standarde	
Nr. rendor	Nr.akti
1	
2	
3	

Hartoi
Nëpunësi përgjegjës

(emër/mbiemër/nënshkrim)